



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1160 Prot.

Tiranë, më 22. 08. 2018

V E N D I M

Nr. 163, Datë 22. 08. 2018

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 70, datë 22.05.2018, e shtetases Xh. D., kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në të cilën pretendon diskriminim *për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes arsimore*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas parashtrimeve të bëra në ankesë, Xh. D. ka qënë në marrëdhënie pune me punëdhënësin, Drejtoria Rajonale Sigurimeve Shoqërore Tiranë (DRSSH), nga data 29.09.2015, në pozicionin “Specialiste Pritëse”, në Agjensinë e Sigurimeve Shoqërore - Rrogozhinë. Me anë të shkresës Nr. 226 prot., datë 02.02.2018, ankuesja është njoftuar nga punëdhënësi Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për zgjidhjen e kontratës së punës, pas përfundimit të afatit të njoftimit, më datë 01.03.2018. Ky veprim i punëdhënësit, pretendohet të jetë kryer për të zëvendësuar atë me një punonjës tjetër, pasi gjatë periudhës që ka ushtruar detyrën e specialistes nuk është marrë asnjë masë disiplinore ndaj saj. Gjithashtu, ankuesja sqaron në vendin e saj është punësuar një person tjetër, i cili nuk plotëson kriteret e pozicionit të punës dhe as nivelin arsimor.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se ankuesja nuk kishte vënë në dispozicion të Komisionerit informacion të mjaftueshëm për të vijuar me shqyrtimin e ankesës, lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe diskriminues nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

Duke qënë se në formularin e ankesës ishte lënë kontakti i ankuesit, atëherë Komisioneri nëpërmjet telefonit dhe email-eve në datat 29-30.05.2018, i kërkoi informacion, me anë të të cilave ankuesja argumenton shkaqet e pretenduara në ankesë.

Me anë të email-it datë 29.05.2018, ankuesja sqaroi KMD-në se: *“Nga ana e DRSSH Tiranë nuk ka asnjë arsye apo motiv për largimin tim të menjëhershëm nga puna dhe as një vendim largimi. Mendoj se është politik largimi nga puna, megjithese unë jam e të njëjtës forcë politike. Babai im Xh. Th. është ndër themeluesit e Partisë Socialiste në Rrogozhinë. Mendoj dhe besoj se këtu ka gisht kryetari i PS Rrogozhinë.”*

Gjithashtu, me anë të email-it datë 30.05.2018, ankuesja sqaroi se: *“Po ju informoj në lidhje me personin i cili me ka zëvendësuar në ish pozicionin tim të punës si specialiste pritëse në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore Rrogozhinë. Ajo quhet E. F. dhe në dijeninë time ajo ka mbaruar studimet në universitetin e Elbasanit në Fakultetin e Ekonomisë vetem në sistemin bachelor pra 3 vjeçar.”*

Në përfundim të ankesës, Xh. D. kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese për shkak të bindjeve politike, të kryer nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, si dhe të vendosë rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së¹, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim ”.*

¹ Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës nr. 718/1 prot., datë 31.05.2018, kërkoi informacion² lidhur me pretendimet e subjektit ankues nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, DRSSH Tiranë informoi³ Komisionerin lidhur me procedurën e ndjekur për largimin nga puna të Xh. D. Në vijim DRSSH Tiranë sqaroi se, në zbatim të dispozitave të Kodit të Punës dhe Rregullores së Institutit të Sigurimeve Shoqërore Nr. 3/2, datë 26.02.2008, janë ndjekur të gjitha procedurat për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Bashkëngjitur shkresës, DRSSH Tiranë vuri në dispozicion të KMD-së vetëm kopje të dosjes personale të ankueses dhe aktet mbi procedurën e ndjekur për largimin e ankueses nga puna.

- Duke qënë se DRSSH Tiranë, nuk vuri në dispozicion informacionin e plotë lidhur me kërkesat e shkresës Nr. 718/1 prot., datë 31.05.2018 të KMD-së, mbështetur në Urdhërin nr. 143, datë 30.07.2018, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë këtij institucioni më datë 06.08.2018, për të administruar informacionin e kërkuar për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së Xh. D.

² - Informacion mbi pretendimet e ngritura në ankesë dhe arsyet e largimit nga puna të Xh. D.

- Kopje të procedurës së ndjekur për largimin nga puna të ankueses.

- Kopje të dosjes personale dhe procedurës së ndjekur për emërimin e punonjësve E. F., në pozicionin e “Specialistes Pritëse”, në Agjensinë e Sigurimeve Shoqërore – Rrogozhinë (pozicion të cilin mbante më parë znj. Deda).

- Informacion rreth kriterëve për emërimin në pozicionin “Specialist Pritës”, në Agjensinë e Sigurimeve Shoqërore - Rrogozhinë.

- Informacion dhe kopje të dosjeve të punonjësve me detyrë “Specialist Pritës”, në Agjensinë e Sigurimeve Shoqërore - Rrogozhinë, të emëruar për periudhën Janar 2018 e në vijim.

³ Me anë të shkresës Nr. 6522/1 prot., datë 06.06.2018, protokolluar pranë KMD-së me Nr. 718/2, datë 11.06.2018

Grupi i inspektimit të Komisionerit, mori takim me L. L., me detyrë Nëndrejtor i DRSSH-së Tiranë.

Gjatë inspektimit, L. L. sqaroi se, gjatë analizës vjetore për vitin 2017 të ISSH-së, më datë 23.01.2018, ndër të tjera, është konstatuar një punë e dobët në shërbimin ndaj qytetarëve nga ana e specialistëve pritës të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore Kavajë dhe Rrogozhinë. Referuar numrit të ankesave të qytetarëve lidhur me pakënaqësitë e shërbimit të ofruar nga specialistët pritës, Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore Rrogozhinë, u morën masa për 3 punonjës dhe në total rreth 50 punonjës të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Ndër punonjësit e larguar nga puna pas analizës vjetore të punës për vitin 2017, ishte dhe Xh. D. Shkaku i largimit të saj nga puna, nuk lidhet me arsyet politike apo gjendjen arsimore të saj, por me mangësitë e konstatuara në punë. Pas largimit të Xh. D. dhe punonjësit A. S., në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore Rrogozhinë, janë emëruar dy punonjës të tjerë, shtetasit A. B. dhe E. F.

Sa i përket dy punonjësve të emëruar, u sqarua se ndërmjet tyre dhe DRSSH-së Tiranë, janë lidhur kontrata me afat 3-mujor dhe janë në periudhë prove. Në përfundim të inspektimit, u administrua kopje e dosjeve të punonjësve të emëruar pranë ALSSH-së Rrogozhinë, pas largimit të Xh. D.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Nga verifikimi i informacioneve dhe dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se, ankuesja më datë 29.09.2015, është emëruar në periudhë prove, në pozicionin “Specialiste Pritëse”, në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore–Rrogozhinë. Më datë 11.12.2015, ndërmjet saj dhe punëdhënësit, Drejtoria Rajonale Sigurimeve Shoqërore Tiranë (DRSSH), është nënshkruar një kontratë pune pa afat të caktuar. Me anë të shkresës Nr. 196 prot., datë 29.01.2018, ankuesja është njoftuar nga punëdhënësi Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për një takim lidhur me vazhdimin e marrëdhënieve të punës. Më datë 31.01.2018, në takimin e mbajtur pranë DRSSH-së Tiranë, ankuesja është njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Me shkresën Nr. 226 prot, datë 02.02.2018, ankuesja është vënë në dijeni se marrëdhëniet e punës me DRSSH-në Tiranë, do të përfundojnë me mbarimin e afatit të njoftimit, më datë 01.03.2018. Në përfundim konstatohet se ankuesja ka punuar pranë punëdhënësit për një periudhë prej 2 vitesh.

Në Kontratën së Punës datë 11.12.2015⁴ të lidhur mes DRSSH-së Tiranë dhe Xh. D. shkruhet se: *“Kur kontrata është pa afat, çdo palë mund ta përfundojë kontratën, duke njoftuar paraprakisht me shkrim sipas afateve që parashikohen në Kodin e Punës”*.

Në interpretim të dispozitave⁵ të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 *“Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”*, i ndryshuar, punëdhënësi mund të zgjidh kontratën e punës në çdo kohë, por për këtë duhet të ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dhe argumenta që justifikojnë zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Nisur nga interpretimet e bëra nga Kolegjet e Bashkuara në vendimin unifikues Nr.19, datë 15.11.2007, rezulton se, barra e provës për të justifikuar zgjidhjen e kontratës së punës i ngarkohet palës punëdhënëse vetëm në rastet e zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës (nenet 153-155 të Kodit të Punës).

Mbështetur në provat dhe informacioni i administruar, gjatë periudhës që ankuesja ka ushtruar detyrën e specialistes pritëse në ALSSH Rrogozhinë, nuk është marrë asnjë masë disiplinore ndaj saj, si dhe nuk u vu në dispozicion të KMD-së asnjë vlerësim pune për ankuesen apo punonjës të tjerë. Gjithashtu, referuar procesverbalit të takimit të mbajtur pranë DRSSH-së Tiranë, për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, nuk është cituar asnjë arsye apo shkak për përfundimin e marrëdhënieve të punës me punëdhënësin.

Gjatë inspektimit të kryer në DRSSH Tiranë, u ngritën pretendime se nga analiza e punës së bërë për vitin 2017, qytetarë të ndryshëm kishin shprehur pakënaqësi lidhur me mungesën e profesionalizmit të specialistëve pritës në Agjencitë Lokale të Sigurimeve Shoqërore Kavajë dhe Rrogozhinë. Sipas DRSSH-së Tiranë, mbështetur në këto ankesa dhe vonesat në kthimin e përgjigjes ndaj qytetarëve, ndaj 3 punonjësve të ALSSH-së Rrogozhinë, janë marrë masa disiplinore, ku për punonjësen Z. Ç., është vendosur masa disiplinore *“kalimi në një klasë më të ulët”*, ndërsa për ankuesen dhe shtetasin A. S., është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Një fakt i tillë, lidhur me mungesën e profesionalizmit të specialistëve të ALSSH-së

⁴ Dorëzuar nga palët gjatë trajtimit të ankesës.

⁵ Neni 143, pika 1, ku parashikohet se: *“Pas kohës së marrjes në provë, për të zgjidhur kontratën me periudhë të pacaktuar, palët duhet të respektojnë një afat njoftimi prej një muaji, gjatë vitit të parë të punës, prej dy muajsh për dy deri në pesë vjet pune, prej tre muajsh për më shumë se pesë vjet pune”*.

Neni 153, ku përcaktohet se: *“1) Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara.*

2) Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t'i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

3) Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit.”

Rrogzhinë, nuk ishte i mbështetur dhe i evidentuar në ndonjë dokument shkresor apo gjatë analizës së punës së bërë për vitin 2017.

Prandaj, nisur nga sa u shqyrtua më lart dhe mbështetur në informacionin dhe provat e administruara, zgjidhja e marrëdhënieve të punës me Xh. D. është bërë pa dhënë ndonjë argument apo justifikim, nëse ka kryer shkelje apo nuk ka realizuar detyrat funksionale të pozicionit të punës.

Në analizë të informacionit dhe legjislacionit të sipërcituar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton nga ana e DRSSH-së Tiranë, nuk janë depozituar prova me anë të së cilave të vërtetohet apo të justifikohet fakti që zgjidhja e kontratës së punës, të jetë bërë për shkaqe të arsyeshme.

Gjithashtu, referuar provave të administruara, rezultoi e provuar se pas largimit të Xh. D. dhe punonjësit A. S., në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore Rrogzhinë, janë emëruar dy punonjës të tjerë, shtetasit A. B. dhe E. F.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Në nenin 12/1/b) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”.*

Në analizë të fakteve dhe informacionit të sipërcituar, u arrit të administroheshin prova me anë të së cilave të vërtetohej se Xh. D. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës, pa shkaqe të arsyeshme.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin⁶ 2 të ligjit nr. 10221, datë 02.04.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen

⁶ Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues i pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Xh. D., ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë diskriminuese për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes arsimore.

1. Sa i përket bindjeve politike

Ankuesja pretendon diskriminim për shkak të bindjeve politike, por gjatë trajtimit të ankesën nuk ka vënë në dispozicion asnjë provë a dokument për të vërtetuar aktivitetin apo bindjet politike të saj.

Gjithashtu, vlen të theksohet fakti se mbështetur në informacionin e administruar, rezulton se ankuesja dhe subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i përkasin të njëjtës bindje politike.

Në këto kushte, Komisioneri konstaton pala ankuese nuk ka paraqitur provat dhe argumentimet e nevojshme, të cilat të krijojnë bindjen se vërtetohet shkakun e pretenduar.

2. Sa i përket gjendjes arsimore

Ankuesja pretendon diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, pasi është zëvendësuar me një punonjëse, e cila ka mbaruar studimet në universitetin e Elbasanit në Fakultetin e Ekonomisë vetëm në sistemin bachelor, pra 3 vjeçar.

Gjatë trajtimit të ankesës së Xh. D., u administrua një kopje e dosjes së saj, ku konstatohet se ankuesja ka përfunduar studimet në degën Administrim-Biznesi dhe disponon diplomë të nivelit Bachelor. Gjithashtu, nga ankuesja është vënë në dispozicion Vërtetim me nota, lëshuar nga

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, me anë të së cilit evidentohet se ankesja aktualisht ndjek studimet në programin e studimit “*Master i Shkencave në Marketing*”.

Përsa më lart, ankesja ka paraqitur prova dhe fakte, për të vërtetuar shkakun e pretenduar të gjendjes arsimore.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar se faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e DRSSH-së Tiranë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁷ dhe trajtimit të pafavorshëm të ankueses.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga DRSSH Tiranë gjatë inspektimit, u konstatua se të dy punonjësit e emëruar në detyrën e specialistëve prites në ALSSH Rrogozhinë, kishin përfunduar arsimin e lartë në degën Administrim-Biznesi. Punonjësjja E. F., ka përfunduar studimet në Fakultetin Ekonomik dhe disponon Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë, ndërsa punonjësi A. B., ka përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor.

Në analizë të provave dhe fakteve të administruara, konstatohet se ankesja dhe punonjësi A. B., kanë të njëjtin nivel shkollimi, pra kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor. Ndërsa punonjësjja E. F., në ndryshim nga ankesja, ka përfunduar studimet në Fakultetin Ekonomik dhe disponon Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë.

Mbështetur në informacionin e administruar në Rregulloren⁸ Nr. 3/2, datë 26.02.2008 “*Për Personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore*”, të ndryshuar, për pozicionin e specialistëve, një nga kriteret e punësimit është Arsimi i Lartë, duke lënë të kuptohet që nuk është i nevojshëm niveli i arsimit Master, për punësimin në pozicionin e specialistit në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Në këto kushte, nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës dhe shpjegimet e dhëna nga palët, nuk provohet fakti që ka patur një trajtim të diferencuar dhe të pabarabartë të ankueses krahasuar me të tjerë, për shkak të gjendjes arsimore.

⁷ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

⁸ Marrë në faqen web të Institutit të Sigurimeve Shoqërore: <http://www.iss.gov.al>

Në përfundim, Komisioneri nuk arriti të administrojë prova për të vërtetuar që, paligjshmëria e veprimeve apo mos veprimeve të DRSSH Tiranë, të lidhen me pretendimet për diskriminim të ngritura nga ankuesja.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/a), b), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të Xh. D., nga ana e DRSSH-së Tiranë, për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes arsimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindje politike dhe gjendja arsimore)
(Fusha: Punësim)